



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QËVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

* MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës/Izvršno Telo Inspektorata Rada
Exekutive Body of Labour Inspectorate

Nr.203

Dt.23.05.2011

PODUJEVË

Në bazë të nenit 5.5 c.të Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr.2002/9, nenit 89 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 25 paragrafi 1.3, dhe nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për greva Nr.03/L-200, TEIP-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, Inspeksioni i Punës në Podujevë më datën 23.05.2011 merr:

V E N D I M

Punëdhënësit Agim Dëshishku, pronar i Subjektit Afarist "FAN" shpk me seli në Podujevë rruga "Skenderbeu" me NRB 70324024-I SHOIPTOHE T GJOBA në shumë prej 2000 € (dymijë eurosh) për shkak të pranimit të 2 (dy) punëtorëve të rij në mardhënje pune Selim Azemin dhe Astrit Sylën gjatë kohës së mbajtjes së grevës së një mumi të punëtorëve, që është konstatuar me Raportin Zyrtar Nr.202 të dates 23.05.2011 e që është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit për Greva.

Pagesa e Gjobës duhet të paguhet në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi në emër të TEIP Prishtinë në llogarinë rrjedhëse nr. 1000430070006532, dhe të informohet Inspektorati i Punës për pagesën e kryer duke e prezentuar Faturën UNIREF me numer serie 000215. Në rast të mos pageses së gjobës, ekzekutimi i saj do të realizohet nëpërmes Gjykatës.

Në bazë të nenit 6.4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

TEIP Prishtinë, Inspeksioni i Punës në Podujevë, me rastin e kontrollimit të jashtëzakonshëm inspektues me Raportin Zyrtar Nr.202 të dt.23.05.2011 është konstatuar se Punëdhënësi Agim Dëshishku gjatë kohës së grevës së një numri të caktuar të punëtorëve-grevistë, ka pranuar në mardhënje pune punëtorë të rij dhe ate Selim Azemi dhe Astrit Sylë për të cilë nuk u prezentuan kontratat e punës.

Pranimi i punëtorëve të lartëcekur është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 13 para.2 të Ligjit për greva, kun ë mënyrë decisive ceket se Punëdhënësi nuk mund të punësoj punëtor të rinj të cilët do të zëvendësojnë pjesëmarrësit në grevë.

Konform nenit 13 para 1. të Ligjit për greva, Punëdhënësi për organizuesit e grevës, pjesëmarrësve grevist dhe ndaj të punësuarëve të tjerë, të cilët e mbështesin grevën, nuk mund të merren masa disiplinore apo materiale dhe nuk mund t'ju ndërpritet mardhënja e punës.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Vendimi pala e paknaqur ka të drejt ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi. MPMS-TEIP Prishtinë nëpërmes Inspeksionit të Punës në Podujevë

T'i dërgohet:

-Punëdhënësit

-Dossieri së lëndës



INSPEKTORËT E PUNËS

L. Xhevat Latifi